

AKT—THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Rainbow Company shpk

Sot ne daten 24.04.2024, une ortaku themelues :

Rozana Jakupi , i datelindjes 19/08/1973 , lindur ne Durres e banuese ne San Benedetto del Tronto (AP), Itali, e pajisur me karte identiteti italiane Nr CA43020IO e leshuar nga komuna e San Benedetto del Tronto me date 21 prill 2021 e vlefshme deri ne 19 gusht 2031 dhe karte identiteti shqiptare H35819038R.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ". kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **Rainbow Company SHPK**.

NENI 1

EMERTIM1 I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet **Rainbow Company SHPK** dhe eshte person juridik shqiptar.

Vepr imtaria e saj regullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008, si edhe Ligjit per QKR-ne .

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne Lagjja 3, Ruga Egnatia, Objekt 2 katesh, Zona Kadastrale 8514, Nr. Pasurie 4/280, Hyrja 1, Ap 10. Durres.

Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Asistencen e shoqerive ne sektoret e organizimit dhe menaxhimit administrativ, kontabilitetit fiskal e taksave dhe ne kryerjen e obligimeve perkatëse.

Realizimin e studimeve dhe kerkimeve në fushën juridike, organizimin e shoqerive marketing administrativ, taksave dhe te punes, si dhe shkencave kompjuterike si ne sektorin publik ashtu edhe ne ate privat, me perjashtim te aktiviteteteve profesionale te rezervuara dhe te mbrojtura.

Konsulenca ne fushen e ekonomise per shoqerite me vemendje te veçante ne kontrollin e

menaxhimin e biznesit te thjeshte si ne sektorin publik dhe ne ate privat.

Asistence ne ceshtjet e zhvillimit ekonomik ne veçanti ne planifikimin dhe realizimin e planeve industriale, artizanale, tregtare ne zonat qe u nenshtrohen stimujve financiare me perjashtim te aktiviteteve profesionale te rezervuara e te mbrojtura.

Grumbullimin, analizimin dhe vlerësimin e te dhenave dhe suport informativ te natyres tregtare, ligjore, hipokastale dhe financiare, analiza financiare, blerjen, pergatitjen dhe shitjen e informacionit tregtar. Kerkimet e statistikave te tregut, publikimin e raporteve periodike te informacioneve tregtare jo per individ private, kerkimin dhe seleksionimin e personelit, aktivitetin e telemarketingut.

Asistence ne zbatimin e sistemeve te kontabilitetit dhe mjeteve te ngjashme te kontrollit te menaxhimit si dhe te gjitha ato mjete statistikore (psh te dhena bankare) te nevojshme per ekzekutimin korrekt te veprimtarisë se pergjithshme të menaxhimit te vete institucioneve.

Promovimin, organizimin dhe / ose menaxhimin, ne vete ose emerimin e paleve te treta, me stafin e vet dhe / ose me ndihmën e paleve te treta, te kurseve dhe seminarit per trajnimin dhe kualifikimin profesional te sipermarresve dhe drejtuesve.

Studim i personalizuar i logove, broshurave, prezantimi dhe çdo mjet tjetër tregtar per institucionet publike dhe private.

Aktivitetin e revizionit te ndermarrjeve ,vleresimin e ndermarrjeve dhe te kuotave sociale, rishikim e kontroll kontabel administrativ financiar, efikasitet te jashtezakonshem e periodik te shogerive dhe te enteve edhe per llogari te autoritetit gjyqesor, ne perputhje me legjislacionin aktual.

Studimin e disiplinave ekonomike, juridike, fiskale, te punës dhe procedurat administrative qe paraqesin kushtet thelbësore per arritjen e objektiveve te lartpermendura me perjashtim te aktiviteteve profesionale te mbrojtura. Shoqeria, per arritjen e objektit social do te jete ne gjendje te ndermarre marreveshje, sipermarre te perbashketa me universitete publike ose private, si dhe institute profesionale, per realizimin e studimeve, projekteve dhe eksperimenteve me perfshirjen e studentëve, mesuesve gjithashtu permes promovimit të bursave studimi te veçanta.

Ushtrimin e asistences dhe sherbimeve te konsulences teknike administrative, financiare, menaxheriale, sigurimet shoqerore, taksave, sigurimeve, ligjore ,organizative, drejtuese e tregtare.

Ofrimin e sherbimeve informatike, telematike dhe te tipit keshillues qe nuk eshte i mbrojtur nga normativa te veçanta.

Ushtrimin e sherbimeve te analizave te procedurave informatike dhe mbledhjen e te dhenave statistikore.

Aktivitet mbeshtetes, konsulence per optimizimin e logjistikes së brendshme dhe të jashtme te biznesit.

Ofrojme sherbimet e nevojshme per menaxhimin ekonomik dhe administrativ te shoqerive, te çdo forme ligjore dhe te tjera subjekte, publike dhe private, si dhe punonjes autonom te institucioneve të pavarura jo tregtare.

Ofrimin e sherbimeve ne favor te shoqerive, konsorciume, shoqatave dhe institucioneve publike dhe private qe kerkojne asistence ne kontestin e aktiviteteve te promovimit dhe zhvillimit te tregtise se jashtme ndermjet studimit te tregut, operacioneve te import eksportit, tenderave dhe rritjen e prezences tregtare ne kuadrin e bashkepunimit ekonomik ne nivel global.

Konsulence ne fushen e sigurise fizike dhe logjike te instalimeve, sistemeve dhe aparateve.

Asistence per shoqerite ne sektorët e testimit dhe analizes teknike ne kontrollin e cilesisë së produkteve dhe sherbimeve te shitura dhe te proceseve te prodhimit.

Asistence per krijimin e sipermarrjeve te reja gjithashtu nepermjet informacionit, udhezimit, trajnimit dhe sherbimeve të konsulences.

Asistence per marrjen e financimeve dhe te kredive ne pergjithesi.

Promovim dhe zbatim te studimeve dhe analizave sektoriale dhe iniciativave te tjera qe synojne rritjen dhe njohjen e tregut dhe imazhin e sektorit artizanal dhe ndermarrjeve te vogla dhe te mesme.

Asistence per qytetarët private ne kryerjen e praktikave administrative, fiskale, bankare, financiare, hartimin e dokumenteve siç janë kontratat, aktet publike ose private.

Blerjen, shitjen, dhenien me qira dhe / ose menaxhimin e pasurive të patundshme vetjake. Shoqeria mund te veproje edhe si agjenci biznesi per informacion, trajnim te procedurave administrative ne pergjithesi kerkesa per çertifikata, ndermjetesim gjuhësor, perkthime kulturore dhe madje perkthime online, shkrim dhe fotokopjim te teksteve dhe dokumenteve, sherbime sekretarie dhe organizime konferencash.

Shoqeria mund te bleje e menaxhoje pasuri te patundeshme ose pjese pronesia ose aksione bashkepronesia ose vlerat e pasurive te paluajtshme, te lidhi marreveshje ose kontrata qiraje per pasuri te paluajtshme si per qellime lidhur me objektin social ose per qellime te tjera.

Shoqeria ka per objekt marrjen e perfaqesimeve te mandateve , te agjentëve të shoqerive dhe koncesionarëve ne emër të shoqerive tregtare, industriale dhe të sherbimeve dhe në pergjithesi marrjen e detyrave qe hyjne ne sferen e ndermjetesimit tregtar. Shoqeria mund te kryeje punë të marketingut dhe kerkim te tregut, si dhe pune promovuese dhe reklamuese si te produkteve qe perfaqeson dhe te tjerave.

Shoqeria per arritjen e objektit social do te jete gjithmone ne gjendje te beje çdo operacion tjetër tregtar, financiar, industrial mobiluar e imobiluar mund te jape garanci e depozita garancie per pale te treta ,te jete ne gjendje vetem me qellim te nje investimi te qendrueshem

dhe jo vendosje ne treg drejtperdrejt ose terthorazi, pjesemarrje ne shoqeri te tjera brenda kufijve ligjore perkatese. Shoqeria mund te perdor kredi te zakonshme ose te subvencionuara (lehtesuara) si dhe leasing dhe kredi ne valute te huaj.

NENI 4

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i Shoqerise Rainbow Company SHPK eshte 1000 Leke. Ky kapital perbehet nga 1 kuote dhe zoterohet ne masen 100% nga ortaku i vetem i saj ,zonja Rozana Jakupi

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar

NENI 6

ORGANET E SHOQERISE

- Asambleja e pergjithshme.
- Administratoret.

NENI 7

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrten e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen e pasqyrave finelnciare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zrnadhimind he zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Pertaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne proçedimet e tjera ndaj administratorit
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
- Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 8

ADMINISTRATORET

Administrator i shoqerise do te jete zonja Rozana Jakupi , i datelindjes 19/08/1973 , lindur ne Durres e banues ne San Benedetta del Tronto (AP), Itali, e pajisur me karte identiteti italiane Nr CA43020IO e leshuar nga komuna e San Benedetto del Tranto me date 21 prill 2021 e vlefshme deri ne 19 gusht 2031 dhe karte identiteti shqiptare H35819038R eci!a emerohet per nje periudhe 5- vjeçare, me te drejte ripertertje.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment nga asambleja, me shumicë te thjeshte te votave, me kusht qe ne mbledhje të marrin pjesë ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shumë se 30% të kuotave. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizajne kete te drejte.

NENI 9

Shpërndarja e fitimit vijtor te shoqërise

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vijtor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqërisë, vendoset te shpërndahet nga asambleja e pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence tu shperndaje ortakeve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Pa ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vijtor te mos u shperndahet ortakeve, por këto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 10

Prishja e shoqerise.

Shoqeria prishet :

a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,

b)me vendim te asamblese se pergjithshme,

c)me hapjen e procedurave te falimentimit,

ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "QKR",

d)me vendim te gjykates,

dh) per arsye te tjera ,te parashikuara ne statut.

NENI 11

Likuidimi i shoqerise.

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit.

Me vendimin e posaçem te Asamblesë së Përgjithshme, të marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve te shoqerise, likuidatori shpërridan pjesën e mbetur te pasurise se shoqërisë ndermjet ortakeve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy herë këtë njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendres Kombëtare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 12

Perfundimi i Likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon çregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas çregjistrimit të shoqerise nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE Rainbow Company

Rozana Jakupi

JAKUPI
Jakupi